

TURGUT OZAL
COLLEGE

MARS 2026

FOUNDERS :
DILJON DURIÇI
ERKA REÇI

Ozal press

KËTË HERË, GAZETA JONË I KUSHTOHEM FEMRAVE – FORCËS DHE FRYMËZIMIT TË TYRE NË ÇDO DITË.



RUBRIKAT

JETA NË SHKOLLËN TURGUT **1**
OZAL

YJET NË FOKUS **2**

KËNDI I KULTURËS **3**

KËNDI KREATIV **4**


A E DINIT SE..? **5**

TOP PICKS **6**

KËNDI SPORTIV **7**

RUBRIKA E MUAJIT **8**

KËNDI I TË QESHURËS **9**



AKTUALITETI NË SHKOLLË



PROVIMET




Në muajin mars, në shkollën tonë u zhvilluan provimet e tremujorit të II-të (2–18 mars), një periudhë që kërkoj përkushtim, disiplinë dhe organizim të mirë nga ana e nxënësve.

Falë punës së tyre të vazhdueshme dhe mbështetjes së mësuesve, nxënësit arritën rezultatet e dëshiruara, duke dëshmuar qëndrueshmëri në përvetësimin e njohurive, aftësi në menaxhimin e kohës dhe përballimin e sfidave. Këto provime përbëjnë një hap të rëndësishëm në ecurinë e tyre akademike.

U urojmë të gjithë nxënësve suksese të mëtijshme dhe përgatitje sa më të mbarë për tremujorin e tretë!

FESTIVALI I SHKENCAVE




Më 19 mars u zhvillua Festivali i Shkencave, ku shkolla jonë konkurroi me shumë shkolla të tjera, duke u përfaqësuar me tre nga projektet më të mira.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet përbën një dëshmi të nivelit të lartë të përgatitjes në fushën e shkencës.

Nga projektet e paraqitura, njëri prej tyre u përzgjedh për të kaluar në fazën e tretë, duke shënuar një arritje të rëndësishme dhe një moment krenarie për shkollën tonë. Ky sukses pasqyron punën e palodhur të nxënësve, si dhe mbështetjen dhe udhëheqjen e vazhdueshme të mësuesve mentorë.

Arritje të tilla motivojnë komunitetin shkollor dhe i japin shkollës suksesin e merituar.





"CINEMA AND LAW" NJË REFLEKTIM MBI BOTËN DIGJITALE

DEPARTAMENTI I DREJTËSISË I UNIVERSITETIT EPOKA, NË BASHKËPUNIM ME PARTNERË ITALIANË, ORGANIZOI NË SHKOLLËN TONË AKTIVITETIN "CINEMA AND LAW". GJATË TIJ U SHFAQ FILMI "(IM) PERFETTA", I CILI TRAJTON NDIKIMIN E RRJETEVE SOCIALE DHE BOTËS DIGJITALE NË JETËN E PËRDITSHME.

DISKUTIMET U PËRQENDRUAN TE MITI I "PERFEKSIONIT" NË RRJETET SOCIALE, FRAGMENTIMI I IDENTITETIT ONLINE DHE SFIDAT LIGJORE TË EPOKËS DIGJITALE. TË FTUARIT SPECIALË NDANË PËRVOJA DHE NJOHURI TË VLEFSHME, DUKE NDIHMUAR NXËNËSIT TË KUPTOJNË MË MIRË RREZIQET DHE NDIKIMET E BOTËS ONLINE.

KY AKTIVITET SHËRBEU SI NJË MUNDËSI E MIRË PËR NDËRGJEGJËSIM DHE REFLEKTIM MBI PËRDORIMIN E RRJETEVE SOCIALE.





Dita e Verës



Dita e Verës është një nga festat më të dashura në Shqipëri, sepse shënon ardhjen e pranverës dhe largimin e dimrit. E festuar më 14 mars, kjo ditë ka rrënjë shumë të lashta, që lidhen me traditat pagane dhe lidhjen e njeriut me natyrën. Është një moment ku gjithçka fillon nga e para: dita zgjatet, moti ngrohet dhe njerëzit ndihen më energjikë. Për ne, është si një "reset" pas ditëve të ftohta, një arsye perfekte për të dalë jashtë, për t'u argëtuar dhe për të shijuar atmosferën plot gjallëri.

Traditat e Ditës së Verës janë interesante dhe plot kuptim. Një nga më të njohurat është përgatitja e ballokumeve, ëmbëlsira tipike e Elbasanit. Gjithashtu, njerëzit vendosin veroret e famshme, si simbol i fatit dhe shëndetit. Në thelb, kjo festë nuk përbën vetëm një traditë, por është festim i gëzimit, duke kaluar kohë me shoqërinë dhe për të mirëpritur një fillim të ri!



KËNDI KREATIV



Për muajin mars kemi përzgjedhur dy piktura të nxënësës së klasës 10-H, Lidia Jovani, të cilat shprehin mirënjohje dhe vlerësim për mësuesit, it si udhërrëfyes në rrugën e dijes.




Udhëtim drejt dijes

Piktura paraqet një libër të hapur që lundron në det, ku mësuesi dhe nxënësi shihen së bashku në një udhëtim simbolik drejt dijes. Ajo tregon se mësimi është një rrugëtim i përbashkët, ku mësuesi udhëheq dhe nxënësi mëson të zbulojë botën.



Flaka që ndriçon të ardhmen

Në këtë pikturë, mësuesi simbolizohet si një qiri që digjet për të ndriçuar rrugën e nxënësve. Mesazhi thekson përkushtimin dhe sakrificën e tyre, duke treguar se drita e dijes vjen falë punës dhe përkushtimit të tyre të vazhdueshëm.





A e dini Se..

“MËSUESI ËSHTË AI QË
HAP DRITARET E DIJES
PËR ÇDO NXËNËS.”

Dita e 7 Marsit


Çdo vit, më 7 mars, festohet Dita e Mësuesit, një ditë kushtuar mirënjohjes ndaj profesionit të nderuar të mësuesit. Është një moment i veçantë, në të cilin nxënësit shprehin respektin dhe falënderimin e tyre, përmes fjalëve dhe gjesteve plot mirënjohje.

Kjo ditë na kujton rolin e rëndësishëm që mësuesit kanë në formimin dhe edukimin tonë, duke ndikuar jo vetëm në dijet që marrim, por edhe në vlerat dhe qëndrimet që na shoqërojnë gjatë gjithë jetës. Përkushtimi dhe durimi i tyre janë një pjesë thelbësore e rrugëtimit të çdo nxënësi.

Tradita e Luleve

Një nga traditat më të bukura të Ditës së Mësuesit është dhurimi i luleve. Nxënësit zgjedhin lule si shenjë falënderimi dhe respekti për punën dhe përkushtimin e tyre gjatë gjithë vitit.

Kjo traditë nuk ka të bëjë thjesht me dhuratën, por me mesazhin që ajo përcjell: mirënjohje, vlerësim dhe dashuri për dijen që mësuesit na japin çdo ditë.



TOP PICKS

-GRA QË FRYMËZOJNË-

Në këtë rubrikë kemi zgjedhur për të prezantuar dy gra, që kanë frymëzuar botën me guximin dhe veprat e tyre, duke treguar se një person i vetëm mund të sjellë ndryshim.

Malala Yousafzai lindi më 12 korrik 1997 në Mingora, Pakistan.

Malala u bë e njohur në botë për mbrojtjen e së drejtës së arsimit për vajzat, sidomos në rajonin e Swatit, ku talebanët ndalonin vajzat të shkonin në shkollë. Që në moshë të re ajo fliste dhe shkruante për rëndësinë e arsimit të vajzave.

Në vitin 2012, në moshën 15-vjeçare, u qëllua nga talebanët, por mbijetoi dhe vazhdoi misionin e saj. Në 2014 fitoi Çmimin Nobel për Paqe, duke u bërë fituesja më e re në histori. Sot, ajo vazhdon të punojë për të mbrojtur të drejtën e vajzave për arsim, në mbarë botën.



Malala Yousafzai




Nënë Tereza

Nënë Tereza, me emrin e lindjes Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, lindi më 26 gusht 1910, në Shkup.

Ajo ishte një misionare me origjinë shqiptare, që ia kushtoi jetën ndihmës ndaj njerëzve në nevojë. Në vitin 1950 themeloi në Kalkutë të Indisë urdhrin humanitar “Misionaret e Bamirësisë”, i cili u përhap më vonë në shumë vende të botës.

Për punën e saj të jashtëzakonshme humanitare dhe përkushtimin ndaj njerëzve në nevojë, Nënë Tereza mori Çmimin Nobel për Paqe në vitin 1979. Nënë Tereza ndërroi jetë më 5 shtator 1997, ndërsa në vitin 2016 u shpall shenjtore nga Kisha Katolike. Ajo mbetet një nga figurat më frymëzuese në botë, simbol i dashurisë, përkushtimit dhe humanizmit.

KËNDI SPORTIV



PËRTEJ REKORDIT



Milano Cortina 2026

JUTTA LEERDAM

Një nga emrat që premtan shumë në botën e sportit është ai i patinazhistes Jutta Leerdam, sportistes me origjinë hollandeze, e cila shkëlqeu duke regjistruar rekordin e saj më të fundit në edicionin e Lojërave Olimpikë Dimërore, Milano Cortina. Me një kohë të jashtëzakonshme prej 1 minutë e 12 sekondash, për distancën 1000m, ajo tregoi se sprinti mbi dyshtemenë e akullit nuk është thjesht shpejtësi fizike, por një kombinim perfekt i teknikës, aerodinamikës dhe kontrollit. Lëvizjet e saj të përpiluara me precizion, pozicioni i trupit mbi akull dhe ritmi konstant e bënë të pamundur për rivalët ti afrohen. Jutta nuk është thjesht një garuese — ajo po rishkruan historinë në sport.

SERENA WILLIAMS

Kur flitet për tenis modern, pak emra ngjallin respekt dhe admirim si, Serena Williams. Me 23 tituj Grand Slam Single, ajo ka vendosur standarde, që shumë atletë ëndërrojnë t'i arrijnë, por pak mund t'i kapin. Çdo ndeshje e saj është një kombinim i fuqisë, shkathtësisë dhe inteligjencës; shërbimi i saj shpërthyes, goditjet e sakta dhe kontrolli në momentet më kritike, e bëjnë të pamundur për kundërshtarit të parashikojë lëvizjet e saj. Por, më shumë se statistikën, ajo ka mënyrën e saj të veçantë të luajturit – të qetë, të kontrolluar dhe gjithmonë me një pasion të dukshëm në fushë. Duke treguar se tenisi nuk është vetëm teknikë, por dhe kontroll, Williams lë gjurmë pas çdo fitoreje.




Wimbledon championship 2016





RUBRIKA E MUAJIT FUQIA E GRAVE

“Prandaj, kur pyesim: ‘Si do të ishte jeta pa gratë?’, përgjigjja është e thjeshtë, shumë më e varfër në ide dhe përparim. Gratë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një forcë e madhe krijuese që ndihmon botën të ecë përpara.”



Aktorja dhe shpikësja **Hedy Lamarr** krijoi një teknologji komunikimi gjatë Luftës së Dytë Botërore, që më vonë u bë baza për Wi-Fi dhe Bluetooth. Sot, pa këtë ide, komunikimi me telefon, interneti dhe shumë pajisje moderne do të ishin shumë ndryshe.



Një tjetër shpikje shumë e rëndësishme është sistemi i alarmit të zjarrit, i krijuar nga **Marie Van Brittan Brown**. Ideja e saj për një sistem sigurie në shtëpi u bë baza për shumë sisteme moderne sigurie që përdoren sot nëpër botë.

Një tjetër shpikje shumë e rëndësishme është **Patricia Bath**. Ajo krijoi Laserphaco Probe, një pajisje që përdoret për të kuruar kataraktin, një nga shkaqet kryesore të verbërisë në botë. Shpikja e saj ka ndihmuar miliona njerëz të rikuperojnë shikimin dhe konsiderohet një hap i madh në mjekësinë okulistike.



Shpesh, shpikjet e grave janë bërë pjesë e jetës sonë të përditshme pa e kuptuar se kush qëndron pas tyre.

KENDI I TË QESHURËS!



“8 Marsi është një ditë e veçantë, dedikuar grave, nënave dhe motrave. Është një ditë për t’u thënë: ‘Faleminderit për gjithçka që bëni çdo ditë—për dashurinë, përkushtimin dhe forcën tuaj. Faleminderit që jeni gjithmonë shtylla e familjes dhe burim i pashtershëm i kujdesit e ngrohtësisë.’”



1. Plotëso fjalët e përziera:

- SRMA → _____
- EUSMSEE → _____
- PSHIUM → _____
- NXËESNI → _____




Funny Quiz

Në mars ndodh diçka qesharake me pushimet:
a) Nxënësit shikojnë diellin dhe harrojnë kohën
b) Pushimi duket si mini-verë
c) Pushimi është gjithmonë 10 minuta

8 Marsi është:
a) Dita Ndërkombëtare e Gruas
b) Dita e Luleve
c) Dita kur nxënësit shpresojnë për më pak detyra

Në mars, moti ka zakon të...
a) Nxehet si verë në pushim
b) Ftohet si dimër në mëngjes
c) Bëjë çfarë të dojë pa leje nga nxënësit





Faleminderit!

SONILA SHEHU
RAJMONDA HAXHIAJ
DILJON DURIÇ 11-G
ERKA REÇI-11G
ORJON BAKA-11G
ANDA ÇEKA-11G
BORA CANA-11G
HERIKA ORUÇI-11G
ESTER HYSA-11G
ERJONA KOVAÇI-11G
BJORN KOÇI-11F
KAMILA SHEHU-11F
JASEMINA AHMATI-12A



PLATFORMAT TONA ONLINE:

▶ YOUTUBE:

- <https://www.youtube.com/@turgutozalhighschooltirana>

🌐 WEBSITE:

- <https://highschool.turgutozal.edu.al>